

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-136/14

**Prishtinë,
7 Dhjetor 2016**

Në çështjen juridike të:

M.K.

Rruga “Milice Urošević”

Kragujevac

Republika e Serbisë

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 të datës 21 gusht 2013 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave nën numrin KPA39982) pas shqyrtimit të mbajtur më 7 Dhjetor 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e M.K. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 të datës 21 gusht 2013; sa i përket Kërkesës së regjistruar me numrin KPA39982.**
- 2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 të datës 21 gusht 2013 sa i përket Kërkesës së regjistruar me numrin KPA39982.**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 6 qershor 2007, M.K. (në tekstin e mëtutjeshëm: Pala ankuese) ka paraqitur një Kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtutjeshëm “AKP”) duke kërkuar të drejtën e ri-posedimit të ngastrës kadastrale me numrin 619/2, me kulturë tokë e kultivuar dhe me sipërfaqe prej 02.04.88 ha, që ndodhet te vendi i quajtur “Vakuvski Zabran”, fshati “Gërmovë”, në Komunën e Vitisë (në tekstin e mëtutjeshëm: prona e kërkuar). Ai deklaroi se humbja e posedimit ndodhi më 17 qershor 1999. Përveç ri-posedimit, pala ankuese po ashtu kërkon kompensimin për përdorimin e pronës pa pëlqimin e tij.
2. Për ta mbështetur kërkesën, pala ankuese në AKP i dorëzoi këto dokumente:
 - Kopjen e Aktgjykimit të lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë në lëndën me numër 246/94 më 9 nëntor 1994, në bazë të të cilit është vërtetuar se toka me sipërfaqen 2.04.88 ha që konfiskuar gjatë periudhës 1945-1952 nga R.K. (babai i palës ankuese) dhe Ndërmarrja “AgroMorava” nga Vitia që obliguar ta njoh palën ankuese si Bartës i së Drejtës Pronësore të ngastrës kadastrale nr.619/2, me kulturë, tokë e kultivuar e klasit 6 dhe me sipërfaqe prej 2.04.88 ha e që ndodhet te vendi i quajtur “Vakuvski zabran”, Gërmovë, Komuna e Vitisë. Aktgjykimi u bë i formës së prerë më 20 dhjetor 1994.
 - Kopjen e ekstraktit nga Lista Poseduese nr.2/94 të lëshuar nga Administrata e Gjeodezisë në Komunën e Vitisë më 30 mars 1995, ku pala ankuese është shënuar si pronar i pronës së kërkuar.
 - Kopjen e Certifikatës së vdekjes nr.03-203-16-V të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil të Komunës së Vitisë më 14 korrik 2008 ku tregohet se R.K. (babai i palës ankuese) ka vdekur më 11 shtator 1984.
 - Kopjen e Aktvendimit të Trashëgimisë lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë në lëndën O.br. 39/94 më 21 shtator 1994, në bazë të të cilit pala ankuese është shpallur trashëgimtari i vetëm pas babait të tij të ndjerë R.K. . Aktvendimi i Trashëgimisë nuk përmban pronën e kërkuar.
3. Më 11 shkurt 2008, Ekipi Njoftues i AKP-së shkoi te vendi ku pretendohet të jetë prona e kërkuar dhe vendosi një shenjë që tregonte se prona ishte objekt i një kërkesë dhe se palët e interesuara duhej t’i paraqitnin përgjigjet e tyre brenda afatit 30 ditor. Prona nuk ishte e uzurpuar. Pasí që identifikimi fillestar i pronës u vlerësua si i pasaktë, njoftimi u përsërit më 17 qershor 2010 duke e publikuar njoftimin në lidhje me kërkesën në Gazetën e Njoftimeve të AKP-së nr.2 të qershorit 2010 dhe në Buletinin e Zyrës për Prona të UNHCR-së. Gazeta dhe lista u lanë në Komunën e Vitisë që pranoi t’ua lë në dispozicion palëve të interesuara. Publikimet e njëjta u lanë në hyrje dhe dalje të fshatit Gërmovë, në Zyrën Kadastrale të Komunës së Vitisë dhe në Gjykatën Komunale të Vitisë. Njoftimi i fundit i kërkesës është bërë fizikisht më 8 maj 2013 dhe prona u gjet e uzurpuar nga persona të panjohur (tokë e kultivuar dhe kullotë).
4. Raporti Verifikues i AKP-së i vitit 2009 theksoi se Aktgjykimi i lëshuar në lëndën nr. 246/94 më 9 nëntor 1994 nga Gjykata Komunale e Vitisë është verifikuar pozitivisht, ndërsa Certifikata për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme është verifikuar negativisht nga Departamenti i Kadastrit të Komunës së Vitisë. Sipas Raportit të Verifikimit të

- datës 1 prill 2011, ngastra kadastrale nr. 619 nuk ishte e ndarë dhe ishte e regjistruar nën emrin S.S. në bazë të Kontratës për Shitblerje nr. 1450/09, që ishte lidhur ndërmjet S.S.t dhe Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit më 24 korrik 2009.
5. Më 13 qershor 2013, pala ankuese ishte kontaktuar nga AKP-ja me telefon dhe ai kishte konfirmuar se humbja e posedimit mbi pronën e kërkuar kishte ndodhur në vitin 1952, kur toka i ishte shitur Ndërmarrjes Shoqërore “Agromorava” (faqet nr. 105,114 dhe 115 të shkresave të lëndës).
 6. Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës, përmes vendimit të tij KPCC/D/A/212/2013, të datës 21 gusht 2013, vendosi që ta hedh poshtë Kërkesën ngase ishte jashtë juridiksionit të tij, mbi bazën se pala ankuese kishte dështuar të tregonte se Kërkesa e tij kishte të bënte me rrethanat që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i viteve 1998/1998.
 7. Vendimi iu dorëzua palës ankuese më 06 shkurt 2014. Ai paraqiti ankesë më 28 shkurt 2014.
 8. Më 16 mars 2016, Gjykata Supreme lëshoi një Urdhër për Zyrën Kadastrale të Komunës së Vitisë duke kërkuar nga kjo e fundit që të paraqet në Gjykatën Supreme shpjegimin nëse Aktgjykimi nr. 246/94, i lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë më 9 nëntor 1994, i cili u bë i formës së pretë më 20 dhjetor 1994, është ekzekutuar ndonjëherë si dhe dokumentacionin e historisë së plotë kadastrale të pronës: ngastrës kadastrale 619/2, tokë e kultivuar e klasit 6 me sipërfaqe prej 02.04.88 ha, që ndodhet te vendi i quajtur Gërmovë.
 9. Më 14 prill 2016, Gjykata Komunale e Vitisë u përgjigj në Urdhrin e lartcekur duke deklaruar: *“Departamenti i Kadastrit të Komunës së Vitisë nuk posedon të dhëna për ndryshimin, regjistrimin, ndarjen, konsolidimin, apo informata tjera në lidhje me disponueshmërinë e pronave të paluajtshme për periudhën 83-85 deri në vitin 1999. Megjithatë, M.K. nuk ka aplikuar pas vitit 1999 që t’i regjistrojë të drejtat e tij të pretenduara mbi pronën në Kadastër. Ngastra e tokës me numrin 619 nuk është ndarë kurrë në 619/2 dhe ka qenë e regjistruar nën emrin e NSH-së ‘Agromorava’. Ngastra e tokës nr. 619 ishte privatizuar në vitin 2009 me Kontratën e Shitblerjes nr. 1450/90 të datës 24 korrik 2009”.*

Pretendimet e palës ankuese

10. Pala ankuese e kundërshton Vendimin e KKPK-së, pasi që, sipas tij, ai mbështetet në vërtetim jo të plotë të fakteve dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Ai për më tepër nënvizoi se pronën e kërkuar e kishte pasur në posedim në mënyrë të pandërprerë nga viti 1995 deri në qershor 1999.
11. Në ankesë, ai jep një prezantim të hollësishëm të dokumenteve që ai i ka dorëzuar me qëllim të vërtetimit të të drejtës së tij të ri-posedimit dhe i propozon Gjykatës Supreme të caktojë një seancë dëgjimore ku do të thirrreshin fqinjët e tij në cilësinë e dëshmitarëve për ta konstatuar të vërtetën në lidhje me pronën e kërkuar dhe faktin se ai është pronari i pronës së kërkuar.
12. Në fund, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që ta pranojë ankesën dhe ta merr një vendim të ri përmes së cilit do të vërtetohej e drejta e tij për ri-posedimin e pronës së kërkuar.

Arsyetime ligjor:

13. KKPK-ja, në Vendimin e saj të kundërshtuar, ka përmendur faktin se pala ankuese nuk ka arritur të provojë se Kërkesa e tij përfshin rrethanat që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i viteve 1998-1999. Pala ankuese ndërkaq pohon se nuk është e vërtetë që ai e ka informuar Sekretarinë Ekzekutive ndonjëherë se humbja e posedimit ka ndodhur që në vitin 1952.
14. Pasi i shqyrtoi dokumentet në shkresat e lëndës, Gjykata Supreme është e mendimit se vlerësimi i KKPK-së ka qenë i saktë dhe se argumentet e ngritura nga pala ankuese nuk kanë mundur të çojnë në ndryshimin e Vendimit.
15. Sikurse mund të shihet në shkresat e lëndës, pretendohet se pala ankuese është kontaktuar nga AKP-ja përmes telefonit dhe gjoja ai kishte konfirmuar se humbja e posedimit mbi pronën e kërkuar kishte ndodhur në vitin 1952. Neni 99, paragrafi 1, i Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton se kërkesa, përgjigja ndaj kërkesës, ankesat dhe deklaratat tjera, kërkesat dhe propozimet që i adresohen gjykatës duhet të dorëzohen në formë shkresore. Kriteri i formës shkresore po ashtu përmbushet në rastin e parashtrësive të dërguara me telegraf, faks apo postë elektronike në qoftë se tregohet dërguesi.
16. Nuk ka prova në shkresat e lëndës se pala ankuese ka dorëzuar deklaratë me shkrim ku deklorohet se humbja e posedimit ndodhi në vitin 1952. Një bisedë telefonike nuk mund të konsiderohet si parashtrësë përmbajtja e së cilës ka ndikim në rezultatin e procedurës.
17. Megjithatë, Gjykata Supreme konsideron se rezultati i procedurës para KKPK-së ka qenë korrekt. Duke e pasur parasysh dokumentacionin e mbledhur në shkresat e lëndës, konkludimi i vetëm i vlefshëm për të drejtat pronësore/të posedimit të palës ankuese është se në të vërtetë asnjë provë nuk tregon se pala ankuese ka qenë në posedim të pronës së kërkuar para apo gjatë konfliktit dhe se humbja e posedimit ka ndodhur për shkak të konfliktit.
18. Pala ankuese nuk ka dorëzuar asnjë dokument në këtë drejtim. Në veçanti, ai nuk ka dëshmuar se Aktgjykimi i Gjykatës Komonale i datës 9 nëntor 1994 është ekzekutuar ndonjëherë, dhe si rrjedhojë M.K. siguroi posedimin e pronës së kërkuar, që më pas ka mundur të humbet për shkak të konfliktit. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ndërkaq ex officio ka gjetur Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme që tregon se prona e kërkuar ishte e regjistruar nën emrin e palës së tretë, në bazë të Kontratës për Shitblerje të lidhur ndërmjet Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tutje: "AKM") dhe palës së tretë. Para privatizimit të pronës së kërkuar nga AKM-ja, ajo kishte qenë e regjistruar në emër të Ndërmarrjes Shoqërore – Kompleksi Bujqësor "AgroMorava".
19. Duke pasur parasysh çfarë është cekur më lartë, Gjykata Supreme pohon se Kërkesa bie jashtë juridiksionit të AKP-së. Fakti se në regjistrat kadastral prona e kërkuar duket se është regjistruar si pronë shoqërore e përjashton mundësinë që AKP-ja ta shqyrtojë lëndën. Për këtë arsye, Kërkesa duhet të hidhej poshtë dhe ankesa të refuzohej si e pabazuar.
20. Në qoftë se pala ankuese dëshiron ta kontestojë titullarin juridik të palëve të treta për pronën e kërkuar, procedura duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara. Pasi që prona e kërkuar siç duket i është nënshtruar shitjes në vitin 2009, AKM-ja dhe Gjykata Supreme nuk mund të vendosin në ri-posedimin potencial të pronës së

- kërkuar pa iu dhënë palëve të asaj Kontrate të Shitblerëse mundësinë që t'i mbrojnë të drejtat e tyre.
21. Lidhur me kërkesën e palës ankuese për kompensim për shfrytëzimin e pronës së tij pa pëlqimin e tij, sipas Ligjit nr. 03/L-079 as Komisioni e as Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme nuk kanë juridiksion të vendosin për këtë.
 22. Në bazë të lartcekurave, në përputhje me nenin 13.3(a) të Ligjit 03/L-079, është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky Aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Anna Bednarek, Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-it